# DËSHMI ARKIVI

**A-452528**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Selia PD - Berisha takon ish kryeministrin e landit të Turingisë: Narkoshteti i kryesuar nga Rama, proble mi madhor i Shqipërisë |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/917365/berisha-takon-ish-kryeministrin-e-landit-te-turingise-narkoshteti-i-kryesuar-nga-rama-problemi-madhor-i-shqiperise/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 14:02:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 13:51:12 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `af8d97418fab2ff1498807b0dfaa4c6d81cd0f7e85ed2c6eb67cec039d54d42e` |
| TEKSTI | `d829a0885dfa097a01bec8f5e9c21be154d882ba755a4fece0f5883c847b9a09` |
| PAMJA | `b9e39fa233cea9d7595dd28830e49dc7646d83865b91277a4c86b47eb2f34aed` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `93e36136a859ba0ebb7c0fa42517ba3dfbfb22323d7182aad163fcb6ccebbed5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/93e36136a859ba0ebb7c0fa42517ba3dfbfb22323d7182aad163fcb6ccebbed5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


PROF. MYQEREM TAFAJ
Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!


SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



# Berisha takon ish kryeministrin e landit të Turingisë: Narkoshteti i kryesuar nga Rama, problemi madhor i Shqipërisë

15:51, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A[a] -

Kryetari i PD-së, Sali Berisha dhe nenkryetari i grupit parlamentar te PD Tomor Alizoti patën një takim me zotin Dieter Althaus ish kryeministre e Landit te Turingisë dhe anëtar i Bordit te Fondacionit Adenauer dhe drejtorin e Fondacionit "Konrad Adenauer", Dr. Thomas Kunze.

Në këtë takim, Berisha theksoi se problemi më madhor me pasoja shkatërrimtare mbi demokracinë, ligjin, shoqërinë dhe ekonominë e Shqipërisë është narkoshteti i kryesuar nga Edi Rama, i pari dhe i vetmi në Evropë.

*"Në këtë kuadër, sot Shqipëria është eksportuesja kryesore e kanabisit në Evropë. Kartelet shqiptare të drogës janë transportuesit kryesorë të kokainës dhe ndër aksionerët kryesorë të tregut të saj në Evropë. Në Shqiperi ato administrojnë portet, të cilat aktualisht janë porte të lira për drogën.*

*Kartelet shqiptare të drogës në Shqipëri dhe në Amerikën Latine kanë lidhje direkte jo vetëm me policinë, gjykatat e prokurorinë, por kanë lidhje direkte të faktuara edhe me kreun e ekzekutivit shqiptar, Edi Ramën, i cili pret në zyrë përfaqësuesit e Sinaloas dhe, në kundërshtim me ligjin, u jep licencë për kazino dhe hotel me pesë yje. Dosjet gjyqësore kanë faktuar se zyra e kryeministrit organizon takime trilaterale, si për shembull në Aruba, mes trafikantëve të drogës, ndërtuesve shqiptarë dhe përfaqësuesve të tij direktë.*

*Pasojat më të rënda të narkoshtetit janë në ekonominë e vendit. Në Shqipëri, më shumë se në çdo vend tjetër në botë, janë çvlerësuar euroja dhe dollari. Monedhat më të fuqishme në planet janë çvlerësuar në 10 vite përkatësisht me 32% dhe 35%, e po aq janë çvlerësuar edhe eksportet e vendit. Për rrjedhojë, prodhimi industrial në Shqipëri, sipas Eurostat-it, ka rënë me 15.3% me shume se ne cdo vend tjeter pas Ukraines. Kurse treguesi i ndërtimit, sektor ku lahen paratë e drogës, është tri herë më i lartë se mesatarja e BE-së.*

*Pasojat më të rënda të narkoshtetit pasqyrohen me shokun demografik të*

## më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti: Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

*Pasojat me të rënda të narkoshtetit pasqyrohen me shokun demografik të pashembullt në historinë tonë. Po sipas Eurostat-it, në 10 vitet e fundit emigruan vetëm në zonën Schengen 1,099,000 qytetarë. Nëse shtohen edhe ata që kanë emigruar në zona të tjera, del se 47% e shqiptarëve janë larguar nga vendi. Regjistri i Gjendjes Civile tregon se lindjet sot kanë rënë në nivelin e 100 viteve më parë, kur Shqipëria kishte nën 1 milion banorë.*

*Problemi madhor lidhur me narkoshtetin qëndron te mohimi i tij, dhe në fakt ky mohim është mbështetje e tij, me dashje apo pa dashje. Po kështu, ideja se narkoshteti në Shqipëri mund të çmontohet nga dy apo tre prokurorë nuk është aspak realiste. Qëndrime të hapura politike kundër tij dhe masa të tjera ndaj regjimit janë të domosdoshme" thuhet në njoftmin për median.*

Në takim u diskutuan gjithashtu probleme të lidhura me farsën zgjedhore, korrupsionin e papërmbajtshëm dhe bllokimin e luftës kundër tij, si dhe mohimin e të drejtave kushtetuese të opozitës në parlament. Berisha falenderoi me mirenjohje CDU, Fondacionin Konrad Adenauer ne Tirane dhe drejtorin e tij Dr Tomas Kunze per mbeshtetjen e cmuar qe i kanë dhene PDSH dhe vendit tone.





© SYRI.net

Lexo edhe:


Noka: Ron Yefet është pjesë e skemës mafioze, KAYO po përdoret për trafik armësh. Rama e solli për punët e pista


'UÇK lindi si përgjigje ndaj gjenocidit të MilloshevIçit!' Kuvendi del me deklaratë pas vendimit të Gjykatës Speciale


Boçi: Shkollat me më pak se 21 nxënës u përjashtuan nga PISA 2025! S'ka transparencë

Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikuara në Serbi

TË NGJASHME

Audio-përgjimet për Ron Yeffet/ Këlliçi në Kuvend: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve

'Njeriu i familjes së Ramës kontrollon qindra miliona euro' Spahia:OSHISH, 12 tendera me vlerë 105 mln euro në 6 javë

Pagat e magjistratëve/ Berisha: Jemi kundër atij projektligji. Buxheti s'është i Surrelit, por i shtetit

Skandali 'KAYO'/ Berisha: Çdo përpjekje për të paraqitur rrezikshmërinë e lartë që ky person paraqet për NATO

Berisha: Lau duart si Ponc Pilati. Rama përdori Bordin e Paqes për të shpëlarë 'krimin e shëmtuar' ndaj Kosovës

Spahia në Kuvend: Operatori i Shërbimeve të Integruara, skemë korruptive për të grabitur miliona euro

Berisha: Kontrabandë e mirëfilltë. Blihen armë në zona lufte, Shqipëria paraqitet si vend prodhues



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.